



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:284706
Datë: 18.02.2025
Numri i dokumentit: 06862335

Ac.nr.5717/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Burim Shala dhe Hunaida Pasuli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Xhennet Shantir, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.R nga Prizreni, me adresë banimi në rrugën “I.C-K nr.**”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Avni Thaçi, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Policia e Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/21 të datës 21.08.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 07.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Policia e Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.****/21 të datës 21.08.2023, në pikën I (një), II (dy) VËRTETOHET.
- II. Pikat III (tre) dhe IV (katërt) të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/21 të datës 21.08.2023, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.****/21 të datës 21.08.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit J.R nga Prizreni. II. DETYROHET e paditura Policia e Kosovës, që paditësit, në emër të kompensimit të një page mujore (pagës së trembëdhjetë) t’ia paguaj shumën nga 638.51 euro (gjashtëqind e

tridhjetë e tetë euro e pesëdhjetë e një cent), për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në shumë të përgjithshme prej 1,915.53 euro (një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë e tre cent) e me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim pranë të paditurës nga data 08.11.2021 e deri në pagimin definitiv, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të “Obligohet” e paditura Policia e Kosovës, që në emër të kompensimit të ushqimit të në punë (shujtave) të paguajë shumën prej 2.50 € për një ditë pune dhe atë për 432 ditë pune, e në shumën e përgjithshme prej 1,080.00 (një mijë e tetëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare”, si e pa bazuar. IV. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 124.00 euro, (njëqind e njëzetë e katër), në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apeli ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e ankimuar apo ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se pala paditëse ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 17.12.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe të shujtave ditore, përmes së cilës ka theksuar se i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se në bazë të Ligjit nr.03/L-2012 të Punës, Ligjit nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, si dhe UA Nr.**/2017 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës dhe UA Nr.**/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i takon e drejta në kompensim e shujtave ditore si dhe paga e trembëdhjetë për vitet 2018, 2019 dhe 2020, me kamatë ligjore, (me detaje të tjera si në petitumin e padisë). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas pranimit të përgjigjes në padi nga e paditura dhe pas vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në bazë të nenit 398 të LPK-së, pa caktuar seancë gjyqësore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.****/21 të datës 21.08.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka arsyetuar se në mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi që nga viti 2003 është në marrëdhënie pune te e paditura. Gjykata përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës DDK**/****/2021 të datës 27.05.2021, vërtetoi faktin se paditësi për punën që e kryen pranë të

paditurës merr pagën prej 638.51 euro në muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2018, 2019 dhe 2020 gjykata vërtetoi faktin se paditësi për vitin 2018 paditësi ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm, vitin 2019 ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, që korrespondon me vlerësimin i kënaqshëm dhe për vitin 2020 ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 3, që korrespondon me vlerësimin i kënaqshëm. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 për çdo fundvit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.**/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi ka qenë për vitin 2018 plotësisht i kënaqshëm, për vitin 2019 ka qenë plotësisht i kënaqshëm ndërsa për vitin 2020 ka qenë i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore. Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë lidhur me kompensimin të ushqimit në punë (shujtave) dhe atë për periudhën 2018 deri 2020, Gjykata ka arsyetuar se paditësi nuk ka arritur që të provoj se këtu me të paditurën si punëdhënëse ka raport kontraktual ku është përcaktuar detyrimi i të paditurës për paditësin për kompensimin e shujtave ditore. Pretendimi i paditësit, se në neni 29 par.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.**/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës përcakton detyrimin mbi ushqimin gjatë ditëve të punës gjykata e gjeti si të pa bazuar, pasi që kjo dispozitë përcakton kushtet të përgjithshme të cilave palët kontraktuese, duhet të ju përmbahen lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, ku kriter për vendosur mbi këto të drejta duhet të jetë vendi i punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici, por si dispozitë nuk përcakton në vetvete detyrimin për kompensim, e në këtë çështje kontestimore kompensimin për shujta ditore. Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të nkimuar.

Lidhur me bazën ligjore ka vendosur konform nenit 5 paragrafi 2, nenit 29 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.**/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, lidhur me nenin 44 paragrafi 2, nenin 47 paragrafi 4 dhe nenin 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe në bazë të Mendimit Juridik për Kamatën e Gjykatës Supreme të Kosovës nr.***/20020, të datës 02.12.2020, dhe për shpenzimet në bazë të nenit 452 par.3 dhe nenit 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPKsë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkallë thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet e palës së paditur lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe i njëjti ka performancë të kënaqshme në punë dhe kjo sipas formularëve për vlerësim të performancës nga të cilat rezulton se paditësi ka pasur performancë të kënaqshme të punës për vitet 2018, 2019, 2020.

Po ashtu pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, nuk qëndrojnë për arsye se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozitat e nenit 44 paragrafi 2 dhe 55 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit për Policinë e Kosovës Nr.04/L-076, pastaj me Udhëzimin Administrativ Nr.**/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht nenin 29 paragrafi 1, i cili parasheh se: “Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parasheh se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”. Pra dispozitat ligjore të nenit të lartpërmendur, përcaktojnë të drejtën për pagën e trembëdhjetë nëse paraprakisht plotësohen dy kushte dhe atë: vlerësimi i kënaqshëm i personelit të policisë, si dhe të njëjtit të mos kenë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe detyruar të paditurën që të njëjtit t’i shpërblejë (kompensojë) pagën e trembëdhjetë, për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Si rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’i paguajë shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në emër të kompensimit të pagave të trembëdhjeta, me të drejtë është bazuar Udhëzimin Administrativ Nr.**/2018 mbi Marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht në nenin 29 paragrafi 2, i cili përcakton të drejtën për pagën e trembëdhjetë kur kemi të bëjmë më vlerësim të kënaqshëm kur kemi të bëjmë më vlerësim të kënaqshëm dhe kur personeli i policisë nuk ka qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës. Këtë çështje e ka

sqaruar edhe Gjykata Supreme e Kosovës përmes Mendimit Juridik GJ.A.nr.***/2023, datë 09.10.2023, në pikën II të tij.

Gjykata e Apelit vlerësoi se, pretendimi i palës së paditur për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për Buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje, fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar në gjykatë për përmbushje të detyrimit.

Gjykata e Apelit të Kosovës, vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi, pasi që për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit dhe për detyrimin e të paditurit për shpenzimet procedurale në aktgjykimin e ankimuar, me ankesë nuk kishte pretendime ankimore nga e paditura për këto pjesë të aktgjykimit.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së si dhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.***/20020, të datës 02.12.2020, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 par.3 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5717/2023, më datë 07.02.2025

Bashkëpunëtore profesionale
Xhennet Shantir

Kryetare e kolegjit
Halide Reka

Numri i lëndës: 2021:284706
Datë: 18.02.2025
Numri i dokumentit: 06862335